



Plani i Zhvillimit Lokal dhe Vlerësim Monitorimi me Pjesëmarrje në Shqipëri – Punët e Komunitetit, Projekti II (PKP II)

Konteksti i projektit

Si pjesë e angazhimit për të rritur kapacitetin e qeverisjes vendore në Shqipëri për t'u përfshirë në zhvillimin e pjesëmarrjes dhe mbështetjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), kontraktoi Institutin Urban dhe partnerët e tij lokalë, në bashkëpunim me stafin e FSHZH, të hartojë një strukturë gjithëpërfshirëse dhe metodologji për Planin e Zhvillimit Lokal (PZHL) dhe Monitorim Vlerësimin me Pjesëmarrje (MVP). Normat kryesore të strukturës së PZHL dhe MVP janë pjesëmarrja në hartim dhe implementim, dhe çka është më e logjikshme, të jetë e realizueshme për të gjithë përfituesit e interesuar.

Komunat pilot

Projekti u shtri në 5 komunat pilot: Maminas, Kastriot, Velipoje, Vithkuq dhe Xarre.

Objektivat

- Prezantimi i koncepteve dhe procesit të PZHL/MVP në komunat e zgjedhura dhe sigurimi i trajnimeve të nevojshme për pjesëmarrësit kryesorë.
- Asistimi i komunave të zgjedhura për zhvillimin dhe përgatitjen e planit të zhvillimit lokal dhe për paraqitjen në këshillin e komunës.
- Sigurimi i asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të komunës për planifikimin e planeve strategjike afatgjata dhe implementimin e projektit, si dhe monitorim vlerësimin me pjesëmarrje.
- Përgatitja e rekomandimeve për modifikimin e strukture dhe metodologjise së PZHL/MVP duke u bazuar në eksperiencën konkrete të programeve pilot dhe për të replikuar programin në komuna e bashki të tjera mbas përfundimit të programit pilot.



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Hapat e projektit

Hapi i pare: Marrja e aprovimit lokal

Hapi i dyte: Dhënia e instruksioneve

Hapi i trete: Fillimi i punës

Hapi i katert: Mbledhja e informacionit

Hapi i peste: Pjesëmarrja e fshatrave

Më poshtë janë të dhënat nga pjesëmarrja e komunitetit në panairë:

- Maminas: 402 pjesëmarrës/ 142 gra
- Kastriot: 383 pjesëmarrës/ 35 gra
- Vithkuq: 155 pjesëmarrës/ 33 gra
- Xarre: 236 pjesëmarrës/ 48 gra
- Velipoja 395 pjesëmarrës/ 42 gra

Hapi i gjashte: Përpilimi i të dhënave, informacioni dhe struktura paraprake.

Hapi i shtate: Puna e nënkomiteteve të fushave prioritare.

Hapi i tete: "Ju folët, ne dëgjuam. A ju

kuptuam drejt?" Mbledhje me komunitetin dhe aprovimi konceptual i PZHL nga këshilli i komunës.

Hapi i nente: Përfshirja në përcaktimin e buxhetit/identifikimi i fondeve.

Hapi i dhjete: Implementimi i PZHL dhe Vlerësim Monitorimi me Pjesëmarrje.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Fondi Shqiptar i Zhvillimit/Banka Botërore

KOHËZGJATIA:

Mars 2005 – Prill 2006

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14

Hyrja 11, Ap. 56

Tiranë

Tel: +355 4 2256840

E-mail: uri@uri.org.al

Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.